



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit

Zyrës së Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 41(2), (6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Hashim Thaçit ("z. Thaçi") është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme. Zhvillimet përkatëse që nga rishikimi i fundit i rregullt i paraburgimit ("Vendimi i Gjashtëdhjetë mbi Paraburgimin")¹ përfshijnë si vijon.
2. Më 24 shtator 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime mbi rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi ("Parashtrimet e ZPS-së").²
3. Mbrojtja e z. Thaçi nuk u përgjigj ndaj Parashtrimeve të ZPS-së.
4. Gjykimi kundër z. Thaçi dhe të bashkakuzuarve vazhdon.³

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e z. Thaçi vijon të jetë e përligjur.⁴ Sipas ZPS-së, që nga vendimi i fundit mbi rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi, nuk ka pasur asnjë ndryshim material të rrethanave që do të përligjte një përfundim të ndryshëm.⁵ ZPS-ja parashtron se asnjë kusht tjetër përveç

¹ F02491, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 14 gusht 2024.

² F02591, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 24 shtator 2024, konfidencial. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 25 shtator 2024, F02591/COR.

³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6-30.

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

paraburgimit në objektin e paraburgimit nuk do të mjaftonte për të zvogëluar rreziqet e përfshira në nenin 41,⁶ dhe se paraburgimi vazhdon të jetë proporcional.⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Dispozitat ligjore të zbatueshme për vendimin në lidhje me paraburgimin përcaktohen në nenin 41 dhe rregullat 56 dhe 57, dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme.⁸ Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

7. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që Trupi Gjykses të përcaktojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtjen në paraburgim.⁹ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse ngrihet para trupit gjykses përkatës, ose *proprio motu*.¹⁰ Në këtë rishikim, ZPS-ja thekson se nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rrethanave që do të mbështeste lirimin e përkohshëm nga paraburgimi.¹¹ Megjithatë, Trupi Gjykses do të bëjë shqyrtimin e faktorëve sipas nenit 41(6), për t'u bindur se vazhdojnë të ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të nevojshëm paraburgimin e z. Thaçi dhe rrjedhimisht përlligjin vazhdimin e tij.

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 22-26.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27-29.

⁸ *Shih, p.sh.*, F00994, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 18-21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 tetor 2022, F00994/RED.

⁹ IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA022/F00005/RED.

¹⁰ IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA010/F00008/RED.

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

A. KRITERET E NENIT 41

1. Dyshimi i bazuar

8. ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer krim që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS").¹²

9. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹³

10. Trupi Gjykues thekson se në bazë të nenit 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁴ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekzistenca e dyshimit të bazuar mirë është vërtetuar edhe në lidhje me akuzat

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

¹³ *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

¹⁴ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar me parashtrimin F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/CONF/RED/A01) me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial të korrigjuar dhe me më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01.

e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Thaçi.¹⁵ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi edhe më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).¹⁶

11. Në mungesë të ndonjë rrethane materiale të re që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykes gjykon se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

2. Domosdoshmëria e paraburgimit

12. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative në bazë të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera.¹⁷ Paraburgimi vazhdohet nëse ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se një ose më shumë nga këto rreziqe do të materializohet.¹⁸ “Të artikulueshme” në këtë kontekst përdoret në

¹⁵ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial, F00777/CONF/RED, versioni i redaktuar publik, F00777/RED, dhe versioni konfidencial me më pak redaktime, F00777/CONF/RED2, u dorëzuan përkatësisht më 22 prill 2022, 6 maj 2022 dhe 16 maj 2022. Ndryshimet e kërkuara paraqiten me hollësi në para. 11. ZPS-ja më pas dorëzoi aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar më 29 prill 2022 (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Aktakuza e Konfirmuar konfidenciale e ndryshuar më tej u dorëzua më 30 shtator 2022, (F00999/A01), me versionin e redaktuar publik (F00999/A03). Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 15 shkurt 2023 (F01296/A03) dhe më 27 shkurt 2023 (F01323/A01).

¹⁶ *Shih, p.sh.*, IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED.

¹⁷ *Shih* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016, para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, *Judgment*, 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, *Judgment*, 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, *Judgment*, 4 July 2019, para. 155.

¹⁸ IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED.

kuptimin që arsyet duhet të specifikohen me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave përkatëse.¹⁹ Në përcaktimin nëse ekziston ndonjë prej arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.²⁰

(a) Rreziku i arratisjes

13. ZPS-ja argumenton se njohuritë dhe të kuptuarit e z. Thaçi të akuzave dhe provave kundër tij janë shtuar për shkak të nxjerrjeve të fundit të materialit dhe vijimit të gjykimit.²¹ ZPS-ja pretendon se z. Thaçi tani është i vetëdijshëm se ajo ka marrë prova të forta në lidhje me orvatjet e pretenduara të tij për pengimin e procesit dhe kryerjen e krimeve të tjera.²² ZPS-ja pretendon se këto rrethana shtojnë motivimin e z. Thaçi për t'u arratisur, duke krijuar mundësi të mjaftueshme reale që ai t'i ikë drejtësisë.²³ ZPS-ja parashtroon se provat e pengimit të procesit mund të anulojnë përfundimet e mëparshme se z. Thaçi ka bashkëpunuar me autoritetet.²⁴

14. Sa i takon argumentit të ZPS-së se njohuritë dhe të kuptuarit e z. Thaçi të akuzave dhe provave kundër tij është shtuar për shkak të nxjerrjeve të fundit të materialit dhe vijimit të gjykimit, Trupi Gjykses thekson²⁵ se ZPS-ja, në thelb, parashtroon të njëjtat argumente të cilat Trupi Gjykses i ka shqyrtuar dhe hedhur

¹⁹ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Ligji nr.08/L-032 jep këtë përkufizim për termin "i artikuleshëm": "pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet".

²⁰ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 22.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁵ *Shih* Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 14.

poshtë në vendime të mëparshme.²⁶ Në këtë drejtim, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të pritët të shqyrtojë parashtrime të cilat vetëm përsërisin argumentet tashmë të trajtuara në vendimet e tij të mëparshme mbi rishikimin e paraburgimit.²⁷ Trupi Gjykses gjykon se ky parim vlen njëllor dhe për fazën aktuale të procesit.²⁸ Në përputhje me konstatimet e veta të mëparshme,²⁹ Trupi Gjykses konstaton se nuk është bindës argumenti i përgjithshëm i ZPS-së se shtohet rreziku i arratisjes për shkak të njohurive më të plota të të akuzuarit për akuzat dhe provat kundër tij.

15. Sa i përket argumentit të ZPS-së se rreziku i arratisjes është shtuar për shkak të faktit që z. Thaçi tani është në dijeni se ZPS-ja ka mbledhur prova kundër tij në lidhje me pengimin e procesit, Trupi Gjykses thekson se z. Thaçi tashmë përballet me akuza që lidhen me krime ndërkombëtare themelore, dhe provat e reja për pengimin e procesit nuk përbëjnë ndryshim të konsiderueshëm të rrethanave që do të përligjinin një konstatim të ndryshëm mbi rrezikun e arratisjes. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja e ka ngritur më parë këtë argument në lidhje me z. Thaçi,³⁰ dhe Trupi Gjykses e ka hedhur poshtë atë.³¹

²⁶ *Krahazo* Parashtrimet e ZPS-së, para. 9 me F01956, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 24 nëntor 2023, konfidencial, para. 22; Versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë (F01956/RED); F01813, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 25 shtator 2023, konfidencial, para. 9, me Shtojcën 1, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë (F01813/RED).

²⁷ KSC-BC-2020-04, IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi mbi Apelin e Shalës"), 11 shkurt 2022, para. 18

²⁸ *Shih gjithashtu* Vendimi mbi Apelin e Shalës, para. 18, ku konstatohet se paneli mund t'u referohet konstatimeve të vendimeve të mëparshme nëse është bindur se provat ose informacionet mbi të cilat u bazuan këto vendime vazhdojnë të mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.

²⁹ *Shih, p.sh.*, F02012, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 15 dhjetor 2023, para. 14-16. Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 14.

³⁰ *Shih* F02086, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 29 janar 2024.

³¹ *Shih* Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 15.

16. Trupi Gjykses konstaton se argumenti i ZPS-së lidhur me mosbashkëpunimin e z. Thaçi nuk është bindës. Bashkëpunimi me ZPS-në dhe DHS-në janë faktorë relevantë për t'u marrë parasysh kur vlerësohet rreziku i arratisjes,³² dhe Trupi Gjykses ka vlerësuar bashkëpunimin e z. Thaçi sepse kur ai u informua lidhur me fletarrestimin e tij, ai dha dorëheqjen si President i Kosovës dhe u dorëzua vullnetarisht në juridiksionin e DHS-së.³³ Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se provat për orvatjet e pretenduara të z. Thaçi për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve ndërkohë që është në paraburgim nuk është relevante për vlerësimin e rrezikut të arratisjes. Këto rrethana trajtohen në mënyrë më të përshtatshme kur të shqyrtohet nëse z. Thaçi ka të ngjarë të pengojë procesin, sikurse trajtohet më poshtë.³⁴ Trupi Gjykses vëren se edhe ky argument është ngritur më parë nga ZPS-ja, dhe është hedhur poshtë prej Trupit Gjykses.³⁵

17. Trupi Gjykses ka shqyrtuar argumentet e ZPS-së duke mbajtur parasysh fazën aktuale të procesit dhe, ndonëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet plotësisht asnjëherë, ai rikonfirmon se nuk konstatoi faktorë të tjerë që ta bindnin mjaftueshëm për të ndryshuar konstatimin e vet të mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes. Trupi Gjykses gjykon se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë pretendimin e vet se ekziston "mundësia mjaftueshmërisht reale" që i akuzuari të arratiset në qoftë se lirohet, bazuar në argumentin e fazës së procesit gjyqësor.³⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi aktualisht nuk përligjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

³² *Shih p.sh.* F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, para. 32. ("Vendimi i Parë mbi Lirimin e Përkohshëm"). Versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00177/RED.

³³ *Shih p.sh.* Vendimi i Parë mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 32.

³⁴ *Shih më poshtë*, para 20-24.

³⁵ *Shih* Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 16.

³⁶ *Shih* Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin, para. 24.

(b) Rreziku i pengimit të ecursisë së procesit të DHS-së

18. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të këtij Trupi Gjykues, ZPS-ja parashtron se z. Thaçi vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.³⁷ ZPS-ja thekson se në Kosovë vazhdon të ekzistojë atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve të kësaj çështjeje gjyqësore dhe çështjeve të tjera gjyqësore në DHS,³⁸ që, siç është konfirmuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, është një faktor i rëndësishëm kontekstual.³⁹ ZPS-ja parashtron se z. Thaçi ka marrë informacion dhe do të vazhdojë të marrë informacion në lidhje me dëshmitarët që ZPS-ja synon t'i thërrasë.⁴⁰ ZPS-ja parashtron se shtohet më shumë rreziku i pengimit të procesit me zbulimin gjatë gjykimit të identiteteve të dëshmitarëve për të cilët është miratuar nxjerrje e vonuar e informacionit.⁴¹ Sipas ZPS-së, kjo vazhdon të shtojë rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të japin dëshmi.⁴²

19. ZPS-ja pretendon se z. Thaçi i ka vërtetuar këto rrezeqe: (i) duke zbuluar informacionin e marrë prej dëshmitarëve të mbrojtur personave që e kanë vizituar në qendrën e paraburgimit; dhe (ii) duke dhënë udhëzime për dëshmitarët e ardhshëm të ZPS-së në lidhje me formën dhe përmbajtjen e dëshmive të tyre të ardhshme;⁴³

20. Sikurse parashtroi ZPS-ja,⁴⁴ Trupi Gjykues tashmë ka konstatuar se z. Thaçi: (i) ka interesin dhe aftësinë për të ndërhyrë në proces; (ii) është orvatur të dëmtojë

³⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10-16 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 21-22).

³⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

³⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12 (ku citohet, ndër të tjera, IA017/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit ("Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin"), 5 prill 2022, konfidencial, para. 41-48. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA017/F00011/RED).

⁴⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13.

⁴¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 13.

⁴² Parashtrimet e ZPS-së, para. 14 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 21).

⁴³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 15 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 22).

⁴⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 20, 24).

DHS-në dhe u ka ofruar përfitime personave të thirrur nga ZPS-ja; (iii) ka pozitë me ndikim në Kosovë që i mundëson mbështetjen e simpatizuesve; dhe (iv) ka më shumë njohuri për provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.⁴⁵

21. Trupi Gjykues vëren se, duke marrë parasysh vijimin e gjykimit, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm të ZPS-së janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren për Mbrojtjen e Thaçi,⁴⁶ dhe, për rrjedhojë, do t'u bëhen të njohura më shumë personave, përfshirë z. Thaçi. Kjo, nga ana e saj, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të japin dëshmi. Në këtë kontekst, lirimi i një të akuzuari në zotërim të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.

22. Sa u përket veprimeve të z. Thaçi në objektin e paraburgimit të përmendura më lart,⁴⁷ Trupi Gjykues rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se duket se z. Thaçi u dha vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtur.⁴⁸ Gjithashtu, dokumentacioni sugjeron se ai i dha një vizitori jo të privilegjuar udhëzime që duhej t'ia përcillte një dëshmitari të ardhshëm të ZPS-së në lidhje me formën dhe përmbajtjen e dëshmisë së atij dëshmitari.⁴⁹ Kjo sjellje mbështet dhe përforcon konstatimin e Trupit Gjykues se lirimi i të akuzuarit do të krijonte rrezik të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së.

23. Gjithashtu, ky rrezik ekziston në një atmosferë të vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në procedurat penale kundër ish-anëtarëve të

⁴⁵ Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Parë mbi Lirimin e Përkohshëm, para. 41.

⁴⁶ *Shih* Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 21.

⁴⁷ *Shih më lart*, para. 19.

⁴⁸ *Shih* F01977, Trupi Gjykues, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit* ("Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit"), 1 dhjetor 2023, para. 35. Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 22.

⁴⁹ Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit, para. 38. Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 22.

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") në Kosovë, që nuk mund të mënjanohet vetëm me masa mbrojtëse.⁵⁰

24. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

(c) Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

25. ZPS-ja u referohet konstatimeve të Trupit Gjykses në Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin dhe parashtron se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë vepra penale të tjera.⁵¹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se rrethanat relevante që u morën parasysh në vlerësimin e rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së, sikurse shtjellohen më lart,⁵² janë njësoj të vlefshme për këtë pikë dhe për rrjedhojë i përfshin edhe ato.⁵³

26. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë vepra penale të tjera.⁵⁴ Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit vlejnë dhe për shqyrtimin e rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera nga z. Thaçi.⁵⁵ Trupi Gjykses thekson gjithashtu se, që nga rishikimi i fundit i paraburgimit⁵⁶, nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat që do të përligjnin një konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.

⁵⁰ Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 23. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykses, *Aktgjykim*, 19 janar 2023, para. 57. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR.

⁵¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17 (*ku citohet* Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 28).

⁵² *Shih më lart*, para. 18-19.

⁵³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18 (*ku citohet* Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin para. 26).

⁵⁴ Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 26.

⁵⁵ *Shih* Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 26.

⁵⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

27. Trupi Gjykses thekson faktin se gjykimi i kësaj çështjeje është në vijim, se identitetet e dëshmitarëve të cënueshëm i janë bërë të njohur z. Thaçi dhe se duhet të shmanget çdo rrezik i kryerjes së veprave penale të mëtejshme

28. Trupi Gjykses gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë vepra penale të mëtejshme sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

3. Përfundim

29. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se në këtë moment nuk ka informacion të mjaftueshëm që të përligjë konstatimin se z. Thaçi mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë, në bazë të standardit përkatës, Trupi Gjykses është bindur se ekziston rreziku i mjaftueshëm që z. Thaçi do të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe të kryejë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykses do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirim të tij trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme këto rreziqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

30. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se: (i) rreziqet përkatëse mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit;⁵⁷ (ii) asnjë nga kushtet e propozuara dhe as masat shtesë të parapara në nenin 41(12) nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese;⁵⁸ (iii) komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve që

⁵⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 34).

⁵⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 23 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 32).

zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së;⁵⁹ (iv) që nga Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, nuk ka ndryshuar asgjë që përligj një vlerësim të ndryshëm të kushteve, qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore;⁶⁰ dhe (v) sjellja e z. Thaçi tani paraqet rrezik jashtëzakonisht më të madh, sa që as kufizimet standarde të komunikimit dhe monitorimi në objektin e paraburgimit nuk janë të mjaftueshme.⁶¹ Rrjedhimisht, duke pasur parasysh nxjerrjen e vazhdueshme të informacionit të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët që lidhet me gjykimin aktual, këto rreziqe shtohen më shumë se kurrë.⁶²

31. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b).⁶³ Neni 41(12) përcakton disa faktorë që duhet të merren parasysh për të siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se paraburgimi duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme masa alternative më të buta, të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁶⁴ Për këtë arsye, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat

⁵⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 25 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 33).

⁶⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

⁶¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

⁶² Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

⁶³ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017"), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova*, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁶⁴ Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140.

e arsyeshme alternative që mund të vendosen dhe jo vetëm ato që parashtrojnë palët.⁶⁵

32. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së veprave penale të tjera, Trupi Gjykses konstaton se, as kushtet e propozuara më parë dhe as masat shitesë të parapara në nenin 41(12), nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁶⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme.⁶⁷ Ato ofrojnë po ashtu një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të identifikohet dhe/ose parandalohet me lehtësi.⁶⁸

33. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikonfirmon se, vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së, përfshirë masat që urdhëroi Trupi Gjykses së fundi,⁶⁹ komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme.⁷⁰

34. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të tjera mund të trajtohet në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses

⁶⁵ IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 86. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 shkurt 2022, IA003/F00005/RED; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

⁶⁶ *Shih* Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 32.

⁶⁷ *Shih* Vendimin e Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 32.

⁶⁸ Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 32.

⁶⁹ *Shih* Vendimin mbi Kushtet e Paraburgimit, para. 84.

⁷⁰ Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 33.

gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi është i domosdoshëm për të shmangur rreziqet në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

35. ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e z. Thaçi vazhdon të jetë proporcionale, duke cituar konstatimet e mëparshme të këtij Trupi Gjykses dhe duke theksuar ecurinë në vijimësi të gjykimit.⁷¹

36. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria e vazhdimi të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe sipas veçorive të saj.⁷² Ndër veçoritë e kësaj çështjeje gjyqësore përfshihen: (i) ndikimi dhe autoriteti i z. Thaçi; (ii) njohja me akuzat dhe provat kundër tij dhe mundësia e dënimit me burgim të gjatë; (iii) rreziku që z. Thaçi do të pengojë procesin e DHS-së; (iv) rreziku i kryerjes, nxitjes ose dhënies së ndihmës për vepra penale të tjera; (v) fakti që masat kufizuese për lirim nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rreziqet; (vi) pesha dhe kompleksiteti i akuzave kundër z. Thaçi; dhe (vii) fakti që gjykimi është në zhvillim e sipër, që tregon ecuri të arsyeshme të procesit.⁷³

37. Bazuar në rrethanat e diskutuara më lart dhe faktin që vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera që nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me zbatimin e masave të arsyeshme alternative, Trupi Gjykses konstaton se, në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje, vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi me dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

⁷¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27 (ku citohet Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 37).

⁷² Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 65.

⁷³ Vendimi i Gjashtëmbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 36.

38. Megjithatë, Trupi Gjykues thekson se z. Thaçi tashmë mbahet në paraburgim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe gjykimi i kësaj çështjeje është i gjatë. Sikurse u vu në dukje më herët nga Trupi Gjykues, kjo kërkon që, si Trupi Gjykues ashtu dhe palët, të kenë veçanërisht parasysh që të sigurojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykues do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. VENDIM

39. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi; dhe
- (b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se **të premten, 22 nëntor 2024**, në orën 16:00, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76

/nënshkrimi/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 14 tetor 2024

Në Hagë, Holandë.